

Gjykata Supreme e Kosovës

Pkl.-Kzz. Nr. 49/2010

Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga

Maria Giuliana Civinini Gjyqtare e EULEX-it në Gjykatë Supreme dhe Gjyqtare Raportuese

Nesrin Lushta Gjyqtare e Gjykatës Supreme – anëtare e kolegjit

Emine Mustafa Gjyqtare e Gjykatës Supreme - anëtare e kolegjit

në ndihmuara nga Maria Rosa del Valle Lopez si procesmbajtëse në lëndën penale kundër të pandehurve:

P. D., i lindur më 8 prill 1978 në Sofje, Bullgari, emri i të atit Ivan, me vendbanim në rrugën _____, Sofje, Bullgari, shtetas i Bullgarisë; në paraburgim që prej datës 18 shtator 2009.

M. I., i lindur më 8 janar 1984 në Sofje, Bullgari, emri i të atit Kiril, me vendbanim në rrugën _____, Sofje, Bullgari, shtetas i Bullgarisë; në paraburgim që prej datës 18 shtator 2009.

Për vepër penale **Hyrje në sistemet kompjuterike** në shkelje të neneve 264 paragrafit (1), 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i të pandehurve P. D. dhe M. I. kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë P. nr. 2397/2009 të datës 14.04.2010 dhe kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Kp.Nr 146/2010 të datës 19.04.2010, në seancën e mbajtur më 8 korrik 2010 pas këshillimit dhe votimit;

Lëshon këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë P. nr. 2397/2009 të datës 14.04.2010 dhe kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Kp.Nr 146/2010 të datës 19.04.2010 mbi vazhdimin e paraburgimit.

Prandaj, të pandehurit P. D. dhe M. I., në paraburgim që prej datës 18 shtator 2009, duhet të qëndrojnë në paraburgim deri sa aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë P nr. 2397 i datës 14.04.2010 me anë të së cilit ata dënohen ndaras me nga një vit e gjysmë burgim të bëhet i formës së prerë dhe jo përtej datës së skadimit të dënimit më **18 mars 2011**.

ARSYETIMI

1. Historia e procedurës

Më 4 prill 2010 Gjykata Komunale në Prishtinë shpalli fajtor P. D.in dhe M. I.in si bashkëkryerës për vepër penale **Hyrje në sistemet kompjuterike** në shkelje të neneve 264 paragrafit (1), 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës dhe i dënon ata me një vit e gjashtë muaj burgim; ndaj aktvendimit është bërë ankesë dhe është në pritje në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Të dy të pandehurit janë në paraburgim që prej datës 18 shtator 2010.

Më 14 prill 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë caktoi vazhdimin e paraburgimit për të pandehurit deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë por jo përtej skadimit të dënimit të shqiptuar nga gjykata, përkatësisht një vit e gjashtë muaj (deri më 18 mars 2011).

Avokatët mbrojtës Osman Havolli dhe Vahid Halili paraqitën një ankesë të përbashkët në dobi të të pandehurve kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë të datës 14.04.2010 që vendosi mbi vazhdimin e paraburgimit deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Më 19 prill 2010 Gjykata e Qarkut në Prishtinë lëshoi aktvendimin Kp. nr. 146/2010 me të cilin refuzohet ankesa dhe vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 14.04.2010 mbi vazhdimin e paraburgimit.

Më 24 maj 2010 avokatët mbrojtës Osman Havolli dhe Vahid Halili duke përfaqësuar të pandehurit paraqitën një kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë kundërt aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë P. nr. 2397/2009 të datës 14.04.2010 dhe kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Kp.Nr 146/2010 të datës 19.04.2010 mbi vazhdimin e paraburgimit.

Më 17 qershor 2010 Prokurori i Shtetit paraqiti një propozim duke propozuar që kjo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të refuzohet si e pabazuar.

Ky aktvendim merr vendim mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të lartpërmendur të paraqitur nga avokatët mbrojtës të të pandehurve mbi vazhdimin e paraburgimit.

2. Arsyetimi

2.1. Nëse tentim hyrja në sistemet kompjuterike është vepër e dënueshme (nenet 20.2 dhe 264.1 KPK).

Avokati mbrojtës i të pandehurve vërteton se “sipas nenit 20.2 të KPK-së, Tentativa për kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet, kurse lidhur me veprat e tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë”. Sipas avokatit mbrojtës, vepra penale e hyrjes në sistemet kompjuterike (neni 264.1 i KPK-së) dënohet me gjobë ose me dënim maksimal prej tre vjetësh burgim, që do të thotë se tentativa e hyrjes në sistemet kompjuterike nuk dënohet përveç nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë; dhe në këtë kuptim KPK-ja nuk parasheh se tentativa e hyrjes në sistemet kompjuterike dënohet. Prandaj, sipas avokatit mbrojtës, tentativa e kësaj vepre penale nuk dënohet dhe prandaj paraburgimi i të pandehurve është i paligjshëm.

Mendimi i Gjykatës Supreme ndryshon në këtë lëndë. Avokati mbrojtës ka lexuar gabimisht ligjin kur tregon se “sipas nenit 20.2 të KPK-së tentativa për të kryer vepër penale të dënueshme me burgim me **më shumë** se tri vjet do të dënohet (...)”; në fakt, ligji përcakton se “Tentativa për kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet (...)”. Kurse avokati mbrojtës thotë “**me më shumë se tre vjet**”, ligji përcakton “**së paku tre vjet**”. Kjo bën dallim substancial ashtu siç do ta sqarojmë më poshtë.

Vepra penale hyrja në sistemet kompjuterike është e dënueshme me burgim prej tri vjetësh sipas nenit 264.1 të KPK-së (dënimi maksimal); dhe sipas nenit 20.2 të KPK-së tentativa për të kryer vepër penale të dënueshme me së paku tri vjet burgim do të dënohet. Prandaj, hyrja në sistemet kompjuterike në tentativë e përcaktuar me nenin 264.1 të KPK-së është në fushën e burgimit të paraparë me nenin 20.3 të KPK-së. Pra, hyrja në sistemet kompjuterike në tentativë e përcaktuar me nenin 264.1 të KPK-së është vepër e dënueshme sipas nenit 20.2 të KPK-së.

Një lëndë e ngjashme tanimë është vendosur nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj “Ap.-Kz.Nr.

394/2007, të datës 2 korrik 2009”. Në këtë lëndë, të pandehurit janë liruar nga gjykata e shkallës së parë nga vepra krimi i organizuar të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/22 dhe nenin 274 të KPK-së; vendimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar nga Gjykata Supreme.

Lidhur me lëndën, neni 1 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2001/22 e përkufizon krimin e organizuar si në vijim: *“Kriminalitetet i organizuar do të thotë kryerja e një krimi të rëndë nga (...)”*. Pra, në mënyrë që të përcaktohet nëse i pandehuri ka kryer veprën penale Krim i organizuar, koncepti i “krimit të rëndë” duhet të definohet së pari. Lidhur me këtë, neni 1 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2001/22 e përkufizon “krimin e rëndë” si në vijim: *“krim i rëndë do të thotë sjellja që përbën një shkëlqje të dënueshme me dënim maksimal të heqjes së lirisë së paku deri në katër vjet”*

Gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se të pandehurit nuk kanë kryer krim të rëndë sipas nenit 1 (b) duke pasur parasysh se nenet 229 të KPK-së dhe 245 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (lidhur me drogat narkotike) parashohin dënimin nga gjashtë muaj deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe, prandaj, dënimi minimal prej më pak se katër vjet është i mundshëm, gjykata e shkallës së parë i ka liruar të pandehurit nga vepra krimi i organizuar të përcaktuar me nenin 274 të KPK-së

Megjithatë, sipas mendimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë plotësisht ka shpërfill fjalën “maksimum” të nenit 1 (b); pra kur ligji i referohet një veprë të dënueshme me MAKSIMUM heqje lirie me SË PAKU katër vjet, do të thotë se një dënim më i vogël se katër vjet gjithashtu mund të jetë i pranueshëm.

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap.-Kž. No.394/2007, të datës 2 korrik 2009 *“Këto trafikime penale të drogës (pikat 1, 2, 3viii) duhet të konsiderohen, në kundërshtim të aktgjykimit të shkallës së parë, si krime të rënda sepse ato janë të dënueshme me burgim prej <së paku katër vjet> (neni 274 (7) 3) KPK.”* Në të vërtetë, *burgimi prej 4 vjet është në fushën e burgimit të paraparë me nenin 245 (2) të KP RSFJ-së dhe nenit (3) të KPK-së.*

2.2. *Falsifikimi, trafikimi dhe përdorimi i kundërligjshëm i kartelave bankare: cilësimi i veprës së vjedhje, mashtrim ose hyrje në sistemet kompjuterike.*

Metodat kriminale të zhvilluara brenda kontestit të shoqërisë informative janë sfidë e vazhdueshme për ndjekjen penale. Në të vërtetë, pasqyra e tanishme nganjëherë na obligon të zgjedhim në mes të mosndëshkimit që del nga zbatimi i përpiktë i parimeve të ligjshmërisë dhe adaptimit të detyrueshëm të modeleve tradicionale në situatat e reja për të cilat ato asnjëherë nuk janë dizajnuar.

Në këtë kontekst, dhe vetëm si referencë, Gjykata Supreme dëshiron të cekë se Këshilli i Bashkimit Evropian ka nxjerrë një Vendimin Kornizë të datës 28 maj 2001 mbi “luftimin e mashtrimeve dhe falsifikimit e mjeteve për pagesë jo me para të gatshme” me qëllim që të “sigurojë se mashtrimi dhe falsifikimi përfshirë të gjitha format e pagesës jo me para të gatshme janë të njohura si vepra penale dhe sanksionohen në mënyrë efektive, proporcionale dhe zbindëse nga të gjitha Shtetet anëtare”. Lidhur me këtë, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Holanda, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e bashkuar në mes të shteteve tjera tanimë i kanë ndryshuar ligjet e tyre nacionale në mënyrë që t’i përmbahen Politikës së Unionit mbi luftimit e falsifikimit, trafikimit dhe përdorimit të kundërligjshëm të kartelave bankare, dy aspektet preventive dhe represive të problemit.

Lidhur me problemin e veçantë të ngritur në këtë procedurë, dënimi i hyrjes në sistemet kompjuterike në tentativë, neni 5 i Vendimit Kornizë të Bashkimit Evropian përcakton se “Secili Shtet Anëtar do të ndër marr masat e nevojshme për të siguruar që pjesëmarrja në dhe nxitja e sjelljes së referuar në nenet 2, 3, dhe 4, ose tentativa për të kryer atë që është referuar në nenin 2 (a), (b) dhe (d) dhe nenin 3, janë të dënueshme.”

Së fundi Kosova nuk i përmbahet standardeve minimale të domosdoshme për tu ballafaquar me sfidat e falsifikimit, trafikimit dhe përdorimit të kundërligjshëm të kartelave bankare; dhe i tërë ky proces që nga fillimi ka treguar mungesën e instrumenteve adekuate ligjore në mënyrë që të adresohet kjo vepër penale në veçanti.

Derisa Kosova t’i ketë instrumentet e duhura ligjore dhe një përshkrim të qartë të formave të ndryshme të sjelljes që kërkojnë kriminalet lidhur me mashtrimin dhe falsifikimin e mjeteve për pagesë jo të me para të gatshme, do të jetë çështje e secilës gjykatë që të adaptojë këto cilësime penale të Kodit Penal të Kosovës (vjedhje, mashtrime, hyrje në sistemet kompjuterike ose të tjera) të cilat i përshtaten më mirë fakteve të veçanta të lëndës, në mënyrë që të gjejnë sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse për këtë sjelle penale të caktuar.

Në përfundim, pretendimi i gabimeve ligjore në Aktgjykimin e kundërshtuar të shkallës së dytë është i pabazuar dhe kërkesa duhet të refuzohet.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Më 19 korrik 2010, Pkl.-Kzz. Nr. 49/2010

Procesmbajtëse
Maria Rosa del Valle Lopez

Kryetare e kolegjit
Maria Giuliana Civinini